

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË QËNDRËN KOMBËTARE TË KULTURËS PËR FËMIJË, TIRANË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në **QKKF Tiranë**, me objekt: “Për zbatimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë në veprimtarinë ekonomiko-financiare, për periudhën 1/1/2009 deri më 31/12/2012” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 107, datë 30/06/2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16, të ligjit nr. 8270, datë 23/12/1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 1/6/2000, me shkresën nr. 190/9, datë 30/06/2012 dërguar **Z. Flamur Shehu, Drejtor i QKKF Tiranë**, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. PROPOZIME PËR NDRYSHIME APO PËRMIRËSIME NË LEGJISLACIONIN NË FUQI.

1. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë në bashkëpunim me Ministrinë Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, *të kërkojë nga Këshilli i Ministrave përmirësimin e VKM nr. 1173, datë 6/11/2009* “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”, me qëllim përcaktimin e tarifave të shpërblimit të cilësisë artistike, pasi deri në këto momente është punuar duke u bazuar në tarifën e VKM nr. 309, datë 21/6/1993 “Për shpërblimin e cilësisë artistike në letërsi, artin figurativ, muzikor, kinematografik, ekzekutiv, interpretativ, publicistik, si dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet kulturore”, në të cilin janë përcaktuar tarifën maksimale të shpërblimit të krijimtarive të artit skenik, artit muzikor, artit kinematografik, të interpretimit dhe ekzekutimit, publicistikës, etj., *vendim i cili është shfuqizuar me VKM nr. 1173, datë 6/11/2009.*

Menjëherë

B. MASA ORGANIZATIVE

1. Me qëllim përmirësimin e punës të Bordit Artistik, në Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, **rekomandojmë që:**

a) Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë dhe Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të marrin masat e duhura për miratimin dhe funksionimin e Bordit Artistik, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për Artin dhe Kulturën” dhe nr. 8480, datë 27/5/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”.

b) Bordi Artistik i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë, të rishikojë dhe të përgatisë rregulloren e funksionimi të tij dhe të miratojë kriteret dhe masën e shpërblimit të cilësisë artistike për çdo vepër që do të realizohet, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për Artin dhe Kulturën”.

c) Anëtarët e Bordit Artistik, përpara marrjes së çdo vendimi të nënshkruajnë një deklaratë me anë të së cilës deklarojnë se, nuk kanë konflikt interesi në kuptim të ligjit nr. 9367, datë 7/4/2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”.

Menjëherë

2. Nisur nga fakti se, në zbatimin e projekteve “Krijimi i Fondit Publik “Aktorët-Regjisorët e Skenografët e Rinj”, për vitin 2010 dhe “Krijimin e Fondit Publik për Artistët e Rinj në QKKF”, për vitin 2011, u konstatuan parregullsi, pasi:

- janë pranuar artistë jo sipas propozimit të Akademisë së Arteve të Bukura dhe të sapodiplomuar në këtë akademi;

- nuk janë dokumentuar shfaqjet e dhëna në pesë qytete të përcaktuara në projekt me premierën e përgatitur prej tyre;

- ka ndryshime midis preventivit origjinal që ndodhet në ministri me preventivin që ndodhet në QKKF dhe me procesverbalin e mbajtur nga komisioni, si për numrin e pranimit ashtu dhe për specialitetin dhe pagesat mujore të tyre;

- janë përfshirë në projekt pa konkurrim dy ish-punonjës të QKKF, nga të cilët njëra ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë;

- është ndryshuar numri i përfituesve nga projekti dhe preventivi i miratuar nga ministri dhe janë ndryshuar tarifat e pagesës të përcaktuara në preventivat përkatës;

- janë pranuar persona jashtë profesioneve të artit përkatësisht të profesioneve Navigator për anijet civile të të gjitha tipave dhe Filozofi Sociale;

- nuk është dokumentuar produktit artistik i realizuar në përputhje me kërkesat e projekteve, etj., duke bërë që të përdoren 765,000 lekë jo sipas destinacionit të përcaktuar në projekt dhe për pasojë projekti nuk ja ka arritur tërësisht qëllimit që është promovimi i artistëve të rinj të sapodiplomuar.

Përsa më sipër, **rekomandojmë që**, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë në të ardhmen për projekte të kësaj natyre, të zbatojë me korrektësi kriteret dhe rregullat e përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore për artin dhe kulturën.

Vazhdimisht

3. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë të marrë masa, për të përmirësuar rregulloren e brendshme të funksionimit të administratës së institucionit në përputhje me strukturën organike dhe në të ardhmen, me ndryshimin e strukturës dhe organikës, të bëjë dhe ndryshimin e rregullores së brendshme.

Deri më 30/9/2012

4. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë të marrë masa që, në përputhje me strukturën organike të institucionit të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 130, datë 14/6/2010 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës së Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë”, ku në përbërje të Sektorit të Financës është dhe pozicioni specialist (jurist), si dhe nisur nga fakti se, institucioni ka nevojë për një jurist, pasi ka marrë jurist me kontratë disa herë për zhvillimin e procedurave të prokurimit publik dhe se, ky institucion harton dhe nënshkruan një numër të konsiderueshëm kontratash me punonjës të jashtëm që marrin pjesë në veprimtaritë artistike që organizohen, të plotësojë organikën me pozicionin e juristit duke bërë rekrutimin në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

Menjëherë

5. Për sa pasqyruar gabimisht në debi të llog. 602 “Mallra e Shërbime”, shpenzimet e kryera për honorarët, për kolaudimin dhe mbikëqyrjen e punimeve të objektit “Rikonstruksioni Elektrik”, Sektori i Financës në përputhje me rregullat për mbajtjen kontabilitetit, të bëjë sistemimin e shumës 39,520 lekë, në debi të llog. 212 “Ndërtime e Konstruksione”.

Menjëherë

6. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, të marrë masa që, në të ardhmen, të eliminojë mangësitë e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimit publik për blerjet me vlerë të vogël dhe të plotësojë dokumentacionin përkatës në përputhje me kërkesat e Udhëzimit të APP-së për këtë qëllim, si dhe për asnjë blerje publike me vlerë të vogël poshtë kufirit të ulët monetar, të mos ndahet për shmangien e kufirit monetar, apo të procedurave të parashikuara.

Vazhdimisht

7. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, të marrë masat e duhura që, në të ardhmen, për shërbimet e udhëtimit jashtë shtetit, në urdhrat e titullarit të përcaktohen të gjitha shpenzimet që përballohen nga institucioni, apo pala pritëse.

Vazhdimisht

8. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, të marrë masat e duhura që, për të gjitha rastet e përdorimit të fondit të veçantë, të përcaktojë në urdhrat e titullarit, qëllimin e dhënies së shpërblimit, për rezultate të mira në punë, për dhënie ndihme, apo për veprimtari social-kulturore, etj., në përputhje me kërkesat e dispozitave ligjore për këtë qëllim.

Menjëherë dhe vazhdimisht

9. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, të marrë masat e duhura që, për të gjitha kontratat administrative për punë, mallra e shërbime, para nënshkrimit nga palët të merret këshillimi nga Avokatura e Shtetit, në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 10018, datë 13/11/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”.

Vazhdimisht

10. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, të marrë masat e duhura që, në të ardhmen për të gjitha rastet e kontraktimit të përkthyesve, personat të jenë të pajisur me dokumentin që provon se janë përkthyes të njohur nga Ministria e Drejtësisë, të pajisur me licencat përkatëse.

Vazhdimisht

11. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, të marrë masat e duhura që, për shpenzimet telefonike të lidhë kontratën përkatëse me operatorin e telefonisë mobile që ofron çmimin më të ulët, cilësinë më të mirë dhe shtrirjen më të gjerë të sinjalit telefonik, dhe pagesa të bëhet kundrejt faturës për shpenzimet faktike.

Vazhdimisht

12. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë të marrë masa e duhura për të krijuar, inventarizuar dhe arkivuar dosjet me dokumentacionin përkatëse për premierat dhe aktivitetet kulturore artistike të zhvilluara nga ky institucion në përputhje me kërkesat e nenit 15 të ligjit nr. 9154, datë 6/11/2003 “Për Arkivat” dhe të nenit 29, modeli 6, 7 e 8 të “Normave teknike profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

Vazhdimisht

13. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë të marrë masa që çdo vit me kryerjen e inventarizimit të pasurisë së institucionit të përfshihet dhe inventarizimi i ndërtesave.

Çdo vit

14. Në tenderin e zhvilluar me objekt “Restaurimi i pjesshëm i ish-godinës së Parlamentit të parë Shqiptar”, rezultoi se, për vendosjen e një ndriçuesi midis dy prozhektorëve në godinë, nuk është vepruar drejt, pasi vlera e ndriçuesit është njëseuar me çmimin e prozhektorit. Për këtë, **rekomandojmë që**, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, të saktësojë çmimin e ndriçuesit dhe vlera e tij, ti likuidohet sipërmarrësit, shoqërisë [REDACTED]

Menjëherë

15. Në tenderin e zhvilluar me objekt “Restaurimi pjesshëm i ish-godinës së Parlamentit të parë Shqiptar”, rezultoi se, në zërin e punës “F. V. basamakë shkallë mermeri 5 cm”, rezultojnë sipas situacionit përfundimtar 9.3 m2, ndërsa sipas librezës së masave rezultojnë 9.32 m2, me trashësinë 3 cm dhe jo 5 cm, që është paraqitur në ofertë dhe në situacionin përfundimtar. Ky ndryshim i bërë në trashësinë e pragut të mermerit, nga 5 cm në 3 cm, duhej pasqyruar edhe në ndryshimin e çmimit për njësi, gjë që nuk është bërë nga shoqëria [REDACTED] dhe nuk është kërkuar nga mbikëqyrësi i punimeve dhe investitori. Për këtë **rekomandojmë që**, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë të saktësojë vlerën për sasinë 9.3 m2 basamakë mermeri 3 cm, që është vendosur në fakt dhe diferencën e vlerës për sasinë e tenderuar 9.3 m2, basamak mermeri 5cm, që i është likuiduar padrejtësisht, t`ja kërkojë shoqërisë [REDACTED]

Menjëherë

16. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të marrë masa që çmimi i biletave për dhënien e shfaqjeve për fëmijë, tarifat e shërbimit për regjistrimin e fëmijëve në rrethet jashtë shkollore (kurset) dhe të okupimeve për dhënien e sallës me qira, të caktohen në bazë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 432, datë 28/6/2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave që krijojnë institucionet buxhetore” dhe Udhëzimit të përbashkët nr. 3, datë 25/10/2006 “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave buxhetore në institucionet e sistemit të MTKRS”, të Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve nr. 9681 prot., dhe Ministrisë së Financave nr. 7554/1 prot.

Menjëherë

17. Për përmirësimin e mjedisit të kontrollit dhe menaxhimin e riskut, **rekomandojmë që:**

- a) Me miratimin e deklaratës së misionit, objektivave dhe të strategjisë, Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë të marrë masa për të bërë të mundur dokumentimin për njohjen e punonjësve me përmbajtjen e saj.
- b) Të përgatisë një udhëzim të brendshëm mbi konfliktin e interesit, ose në rregulloren e saj të brendshme të përfshihet një nen për të.
- c) Të kryejë vlerësime periodike të punonjësve lidhur me detyrat që ata kryejnë.
- d) Për ruajtjen dhe zhvillimin e kompetencave profesionale të punonjësve të hartojë programe specifike për trajnimin e tyre.
- e) Të marrë masa për të hartuar dhe miratuar strategjinë e riskut.

Menjëherë dhe vazhdimisht

18. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë në bashkëpunim me Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, të marrë masa që në të ardhmen regjistrimet kontabël të bëhen me anë të programeve kompjuterike të licencuara, si dhe sistemi i IT-së, të pajiset me një procedurë për hedhjen e të dhënave rezervë me qëllim që, në rast aksidenti të bëhet e mundur ripërfitimi i të dhënave.

Menjëherë

19. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, të marrë masa që, strukturat përkatëse të saj krahas informacioneve, apo evidencave të ndryshme të informojnë titullarin dhe me anë të raporteve javore, mujore apo tremujore.

Menjëherë

C. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

1. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë të marrë masat e duhura dhe të ndjekë procedurat ligjore, për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik **në shumën 477,900 lekë**, nga 20 punonjës të brendshëm përfituar padrejtësisht më tepër se sa pagat mujore të përcaktuara sipas pozicioneve të strukturës organike nga punonjës të institucionit, për organizimin e Festivalit të 48-të të Këngës për Fëmijë të mbajtur në Tiranë, pasi shpërblimi i dhënë mbështetet në një dispozitë ligjore të shfuqizuar, si dhe nuk ka lidhje me cilësinë artistike të veprave të artit skenik, por me punën e tyre të përditshme të përcaktuar në ligjin për artin dhe kulturën, strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme të institucionit.

Menjëherë

2. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë të marrë masat e duhura dhe të ndjekë procedurat ligjore, për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik **në shumën 395,100 lekë**, nga 28 punonjës të brendshëm përfituar padrejtësisht më tepër se sa pagat mujore të përcaktuara sipas pozicioneve të strukturës organike nga punonjës të institucionit, për organizimin e Premierës “60 vjetori i Teatrit Kombëtar për Fëmijë dhe koncerti i fund vitit”, pasi shpërblimi i dhënë mbështetet në një dispozitë ligjore të shfuqizuar, si dhe nuk ka lidhje me cilësinë artistike të veprave të artit skenik, por me punën e tyre të përditshme të përcaktuar në ligjin për artin dhe kulturën, strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme të institucionit.

Menjëherë

3. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë të marrë masat e duhura dhe të ndjekë procedurat ligjore, për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, për 18 punonjës të brendshëm **në shumën 386,100 lekë**, e përfituar padrejtësisht më tepër se pagat mujore të përcaktuara sipas pozicioneve të strukturës organike nga punonjës të institucionit, për organizimin e Festivalit të 47-të, të Këngës për Fëmijë të mbajtur

në Tiranë, pasi shpërblimi i dhënë mbështetet në një dispozitë ligjore të shfuqizuar, si dhe nuk ka lidhje me cilësinë artistike të veprave të artit skenik, por me punën e tyre të përditshme të përcaktuar në ligjin për artin dhe kulturën, strukturën organike dhe në rregulloren e brendshme të institucionit.

Menjëherë

4. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, të marrë masat e duhura dhe të ndjekë procedurat ligjore, për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik **në shumën 119,640 lekë**, e përfituar padrejtësisht nga shoqëria [REDACTED] nga e cila 36,000 lekë, për vlerën e skrapit nga heqja e zgarave të vjetra prej hekuri, 63,360 lekë për diferencën e çmimit të sasisë të ulluqeve prej bakri të preventivuar dhe të ofertuar, me sasinë e ulluqeve me material llamarine të vendosura në fakt dhe 20,280 lekë, për vlerën e një ndriçuesi të pa vendosur në objekt dhe që i është likuiduar shoqërisë [REDACTED]

Menjëherë

5. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, të marrë masat e duhura dhe të ndjekë procedurat ligjore, për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik **në shumën 23,070 lekë**, e përfituar padrejtësisht nga mosrespektimi i tarifave të përkthimit nga gjuha Bullgare në gjuhën Shqipe, përkatësisht nga përkthyesit [REDACTED] në shumën 11,070 lekë dhe [REDACTED] 12,000 lekë.

Menjëherë

6. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, të marrë masa dhe të ndjekë procedurat ligjore, për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik **në shumën 15.000 lekë**, të shkaktuar nga përdorimi mbi kufirin e lejuar të fondit të veçantë.

Menjëherë

7. Qendra Kombëtare e Kulturës për Fëmijë, të marrë masat e duhura dhe të ndjekë procedurat ligjore, për të kërkuar shpërblimin e dëmit ekonomik, në shumën **14,594 lekë** e përfituar padrejtësisht nga [REDACTED] për kryerjen e shpenzimeve telefonike me celular pa kontrate të lidhur me operatorët e telefonisë mobile dhe mbi limitin e lejuar.

Menjëherë

D. MASA DISIPLINORE

D.1 Për Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

- Mbështetur në nenin 9, të ligjit nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për Artin dhe Kulturën”, pika 4, kërkojmë të fillojmë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Shkarkim nga detyra”, neni 9, pika 4, për:

Z. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe Kryetar i Bordit Artistik.

1. Për mosplotësimin e strukturës organike të institucionit me pozicionin e juristit të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 130, datë 14/6/2010 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë”.

2. Për mos hartimin e rregullores së brendshme të institucionit në përputhje me strukturën organike të miratuar me Urdhrin e Kryeministrit nr. 130, datë 14/6/2010.

3. Për lidhjen e Kontratës nr. 141, datë 28/4/2011, me objekt: “*Rikonstruksioni i pjesshëm i Parlamentit të parë Shqiptar*”, në shumën 5,811,393 lekë, pa marrë më parë mendimin e Avokaturës së Shtetit, në kundërshtim me ligjin nr. 10018, datë 13/11/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, nenet 2 e 5, germa “a”, neni 12, pikat 1 e 5 dhe neni 15, pikat 4 e 9.

4. Për kontraktimin e përkthyesit të jashtëm pa dokumente që vërtetojnë njohjen nga Ministria e Drejtësisë si përkthyes i jashtëm, në kundërshtim me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave nr. 3165, datë 12.05.2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shërbimit të përkthimit të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, i ndryshuar, pikat 1, 2, 10 e 12.

5. Për likuidimin e shpenzimeve telefonike me celular pa kontratë me operatorin telefonik, dhe mbi kufirin e lejuar në kundërshtim me kërkesat e Vendimit të KM nr. 864, datë 23.07.2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik publik”, pikat 9 dhe 14, duke shkaktuar ***dëm ekonomik në shumën 14,594 lekë.***

Për parregullsitë dhe shkeljet e konstatuar në funksionimin e Bordit Artistik (Këshillit Artistik), përkatësisht:

6. Bordi Artistik (Këshillit Artistik) për vitet 2010-2011, ka funksionuar me një anëtar të brendshëm më tepër dhe pa përfaqësues të Ministrisë së Financave, në kundërshtim me ligjin nr. 9631, datë 30/10/2006 “Për Artin Skenik” dhe nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për Artin dhe Kulturën”, neni 10, pika 3.

7. Për marrjen e vendimit nr. 53/1, datë 5/3/2010, nga Bordit Artistik (Këshillit Artistik) një muaj më parë se miratimi i këtij këshilli nga Ministri.

8. Për mosfunksionimin e Bordit Artistik (Këshillit Artistik) në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8480, datë 27/5/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, pikat 1 e nenit 2 dhe neni 16.

9. Për mospërcaktimin e kriterëve dhe kushteve të shpërblimit të cilësisë artistike për çdo vepër që do të realizohet, në kundërshtim me nenin 11 germa “ç” të ligjit

nr. 9631, datë 30/10/2006 “Për Artin Skenik” dhe nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për Artin dhe Kulturën”.

10. Për marrjen e vendimeve të Bordit Artistik (Këshillit Artistik) pa plotësuar nga të gjithë anëtarët deklaratën se nuk kanë konflikt interesi, në kundërshtim me ligjin nr. 9631, datë 30/10/2006 “Për Artin Skenik” dhe nr. 10352, datë 18/11/2010 “Për Artin dhe Kulturën”, neni 10, pika 4.

11. Për marrjen e vendimeve të Bordit Artistik (Këshillit Artistik) për shpërblimin e cilësisë artistike duke u bazuar në vendimin e KM nr. 309, datë 21/6/1993 “Për shpërblimin e cilësisë artistike në letërsi, artin figurativ, muzikor, kinematografik, ekzekutiv, interpretativ, publicistik, si dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet kulturore”, i cili është shfuqizuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1173, datë 06/11/2009 “Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”, pika 11, duke shpërblyer padrejtësisht punonjësit e brendshëm të institucionit dhe për rrjedhojë është shkaktuar **dëm ekonomik për buxhetin e shtetit gjithsej në shumën 1,259,100 lekë.**

12. Për parregullsitë e konstatuara në realizimin e projektit “Krijimi i fondit publik “Aktorët- Regjisorët e Skenografët e Rinj” në vitin 2010 dhe projektit “Krijimi i fondit publik për artistët e rinj në QKKF” në vitin 2011, pasi janë pranuar artistë jo sipas propozimit të Akademisë së Arteve të Bukura dhe artistë të sapo diplomuar në AAB, zbatimin e preventivave të projekteve me dokumente jo origjinale, por kopje të cilët ndryshojnë me dokumentet origjinale që ndodhen në arkivin e ministrisë, si për numrin e pranimit ashtu për specialitetin dhe pagesat mujore të tyre. Përfshirja në projekt e dy ish-punonjësve të QKKF (nga të cilët njëri ka mbushur moshën e pensionit të pleqërisë), pa konkurrim, pranimi i personave jashtë profesioneve të artit (navigator dhe filozofi sociale), si dhe mosdokumentimi i produktit artistik që pritej të realizohej e ka bërë jo efektiv këtë projekt, pasi qëllimi e këtij projekti ishte promovimi i artistëve të rinj të sapodiplomuar.

13. Për mos inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të projekteve artistike për vitet 2010-2011, në kundërshtim me nenin 15, të ligjit nr. 9154, datë 06/11/2003 “Për Arkivat” dhe me nenin 29, modeli 6, 7 dhe 8 të “Normave teknike profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”.

- Mbështetur në nenin 25, të ligjit nr. 8549, datë 11/11/1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe pikën 1 e 2 të vendimit të Këshillit të ministrave nr. 306, datë 13/6/2000 “Për disiplinën në shërbimin civil, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me paralajmërim”, neni 25, pika 3, germa “b”, për:

Z. ██████ me detyrë Përgjegjës i Sektorit të Diversitetit Fetar në Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në cilësinë e ish-Drejtor i Përgjithshëm i Qendrës Kombëtare të Kulturës për Fëmijë dhe ish-Kryetar i Bordit Artistik për vitin 2009.

1. Për mos përcaktimin në Urdhrat e Titullarit të shpenzimeve që duhet të mbulojë institucioni, apo pala pritëse për shërbimet jashtë shtetit, në kundërshtim me vendimin e KM nr. 304, datë 8/5/2003 “Për mbulimin e shpenzimeve dhe për dietat për punonjësit e ministrive dhe institucioneve buxhetore kur dalin jashtë shtetit”, pika 9 dhe Udhëzimin e Ministrisë së Financave nr. 16, datë 24/7/2003 “Për zbatimin e VKM nr. 304, datë 8/5/2003”, pika 1.

2. Për dhënien e shpërblimeve në vitin 2009, në kundërshtim me kërkesat e vendimit të KM nr. 369, datë 13/6/2007 “Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore”, pasi në Urdhrat e Titullarit, nuk është cilësuar qëllimi i dhënies së shpërblimit, si dhe dhënia e shpërblimit me rastin e 8 marsit me bordero, pa justifikuar organizimin e ndonjë veprimtarisë social-kulturore, duke shkaktuar një dëm ekonomik të paarkëtueshëm në shumën 102,600 lekë, për shkak të parashkrimit, pasi në momentin e konstatimit kanë kaluar 3 vjet.

3. Për lidhjen e kontratës datë 17/8/2009, me objekt “Rikonstruksion i rrjetit elektrik”, në shumën 1,222,126 lekë, pa marrë më parë mendimin e Avokaturës së Shtetit, në kundërshtim me ligjin nr. 10018, datë 13/11/2008 “Për Avokaturën e Shtetit”, nenet 2 e 5, germa “a”, neni 12, pikat 1 e 5 dhe neni 15, pikat 4 e 9.

4. Për kontraktimin e përkthyesit të jashtëm pa dokumente që vërtetojnë njohjen nga Ministria e Drejtësisë si përkthyes i jashtëm, në kundërshtim me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave nr. 3165, datë 12/5/2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shërbimit të përkthimit të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, i ndryshuar, pikat 1, 2, 10 e 12.

5. Për caktimin e ██████ si anëtare e Bordit Artistik (Këshillit Artistik) bazuar në propozimin e Drejtorit të Përgjithshëm me shkresën nr. 182, datë 18/9/2008, por pa miratim të Ministrit.

Për parregullsitë dhe shkeljet e konstatuar në funksionimin e Bordit Artistik (Këshillit Artistik), pasi;

6. Bordi Artistik (Këshillit Artistik) për vitet 2009, ka funksionuar me një anëtar të brendshëm më tepër, në kundërshtim me ligjin nr. 9631, datë 30/10/2006 “Për Artin Skenik” neni 10, pika 3.

7. Për mosfunksionimin e Bordit Artistik (Këshillit Artistik) në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8480, datë 27/5/1999 “Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”, pikat 1 e neni 2 dhe neni 16.

8. Për mospërcaktimin e kriterëve dhe kushteve të shpërblimit të cilësisë artistike për çdo vepër që do të realizohet, në kundërshtim me nenin 11 germa “ç” të ligjit nr. 9631, datë 30/10/2006 “Për Artin Skenik”.

9. Për marrjen e vendimeve të Bordit Artistik (Këshillit Artistik) pa plotësuar nga të gjithë anëtarët deklaratën se nuk kanë konflikt interesi, në kundërshtim me ligjin nr. 9631, datë 30/10/2006 *“Për Artin Skenik”* neni 10, pika 4.

10. Për mos inventarizimin dhe arkivimin e dokumentacionit të projekteve artistike për vitin 2009, në kundërshtim me nenin 15, të ligjit nr. 9154, datë 6/11/2003 *“Për Arkivat”* dhe me nenin 29, modeli 6, 7 dhe 8 të *“Normave teknike profesionale dhe metodologjike të Shërbimit Arkivor në Republikën e Shqipërisë”*.

“Kalim në një detyrë të një niveli, apo klase më të ulët për 1 vit”, neni 25, pika 3, germa “ç”, për:

Zj. █████ me detyrë Drejtore e Drejtorisë së Artit dhe Kulturës në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, në cilësinë e Anëtares së Bordit Artistik (Këshillit Artistik) dhe përfaqësuese e ministrisë në Bordin Artistik të QKKF.

Për parregullsitë dhe shkeljet e konstatuar në funksionimin e Bordit Artistik (Këshillit Artistik), pasi:

1. Për marrjen e Vendimit nr. 53/1, datë 5/3/2010, nga Bordit Artistik (Këshillit Artistik) një muaj më parë se miratimi i këtij këshilli nga Ministri.

2. Për mosfunksionimin e Bordit Artistik (Këshillit Artistik) në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 8480, datë 27/5/1999 *“Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike”*, pikat 1 e nenit 2 dhe neni 16.

3. Për mospërcaktimin e kriterëve dhe kushteve të shpërblimit të cilësisë artistike për çdo vepër që do të realizohet, në kundërshtim me nenin 11 germa “ç” të ligjit nr. 9631, datë 30/10/2006 *“Për Artin Skenik”* dhe nr. 10352, datë 18/11/2010 *“Për Artin dhe Kulturën”*.

4. Për marrjen e vendimeve të Bordit Artistik (Këshillit Artistik) pa plotësuar deklaratën se, nuk ka konflikt interesi, në kundërshtim me ligjin nr. 9631, datë 30.10.2006 *“Për Artin Skenik”* dhe nr. 10352, datë 18/11/2010 *“Për Artin dhe Kulturën”*, neni 10, pika 4.

5. Për marrjen e vendimeve të Bordit Artistik (Këshillit Artistik) për shpërblimin e cilësisë artistike duke u bazuar në vendimin e KM nr. 309, datë 21/6/1993 *“Për shpërblimin e cilësisë artistike në letërsi, artin figurativ, muzikor, kinematografik, ekzekutiv, interpretativ, publicistik, si dhe për kontributin e angazhimit të përkohshëm në projektet kulturore”*, i cili është shfuqizuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1173, datë 6/11/2009 *“Për përcaktimin e rregullave për organizimin e ngjarjeve kulturore, artistike dhe sociale nga organet e qeverisjes qendrore dhe institucionet e tjera publike, të pavarura”*, pika 11, duke shpërblyer padrejtësisht punonjësit e brendshëm të institucionit dhe për rrjedhojë është shkaktuar ***dëm ekonomik për buxhetin e shtetit gjithsej në shumën 1,259,100 lekë.***

6. Për parregullsitë e konstatuara në realizimin e projektit “Krijimi i fondit publik “Aktorët- Regjisorët e Skenografët e Rinj”, në vitin 2010 dhe projektit “Krijimi i fondit publik për artistët e rinj në QKKF”, në vitin 2011, pasi janë pranuar artistë jo sipas propozimit të Akademisë së Arteve të Bukura dhe artistë të sapo diplomuar në AAB, zbatimin e preventivave të projekteve me dokumente jo origjinale, por kopje të cilët ndryshojnë me dokumentet origjinale që ndodhen në arkivin e ministrisë, si për numrin e pranimin ashtu për specialitetin dhe pagesat mujore të tyre. Përfshirja në projekt e ish-punonjësve të QKKF, pa konkurrim, pranimi i personave jashtë profesioneve të artit (navigator dhe filozofi sociale, si dhe mosdokumentimi i produktit artistik që pritej të realizohej, e ka bërë jo efektiv këtë projekt, pasi qëllimi e këtij projekti ishte promovimi i artistëve të rinj të sapodiplomuar.

D.2 Për Qendrën Kombëtare të Kulturës për Fëmijë.

Bazuar në ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar me ligjin nr. 9125, datë 29.07.2003, neni 37 dhe kontratën individuale lidhur midis punëdhënësit dhe punëmarrësit, neni 7 “Shkeljet dhe masat disiplinore”, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore:

“Vërejtje me shkrim”, për:

Zj. [REDAKTUAR] me detyrë Drejtore e Teatrit të Fëmijëve:

Për parregullsitë e konstatuara në realizimin e projektit “Krijimi i fondit publik “Aktorët- Regjisorët e Skenografët e Rinj”, në vitin 2010 dhe projektit “Krijimi i fondit publik për artistët e rinj në QKKF”, në vitin 2011, pasi janë pranuar artistë jo sipas propozimit të Akademisë së Arteve të Bukura dhe artistë të sapo diplomuar në AAB. Përfshirja në projekt e ish-punonjësve të QKKF pa konkurrim, pranimi i personave jashtë profesioneve të artit (navigator dhe filozofi sociale, si dhe mosdokumentimi i produktit artistik që pritej të realizohej e ka bërë jo efektiv këtë projekt, pasi qëllimi e këtij projekti ishte promovimi i artistëve të rinj të sapodiplomuar.

Zj. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Financës

1. Për parregullsitë e konstatuara në realizimin e blerjeve me vlerë vogël, pasi për procedurat e blerjeve të zakonshme ka mbajtur edhe procesverbale si blerje emergjente, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 1, datë 10/01/2007 “Për rregullat e Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Kreu VI, pika 2 dhe me Udhëzimin e APP-së nr. 2, datë 18/2/2008 “Për procedurat e prokurimit me vlera të vogla”.

2. Për pranimin e mallrave në magazinë dhe marrjen në dorëzim të shërbimeve të kryera pa procesverbal kolaudimi, në kundërshtim me nenin 13, të ligjit nr. 6942,

datë 25/12/1984 “Për administrimin, ruajtjen, dokumentimin dhe qarkullimin e vlerave monetare dhe materiale”.

3. Për dhënien e shpërblimeve në vitin 2009, në kundërshtim me kërkesat e vendimit të KM nr. 369, datë 13/6/2007 “Për fondin e veçantë në institucionet buxhetore”, pasi në Urdhrat e Titullarit, nuk është cilësuar qëllimi i dhënies së shpërblimit, si dhe dhënia e shpërblimit me rastin e 8 marsit me bordero, pa justifikuar organizimin e ndonjë veprimtaria social-kulturore, duke shkaktuar **dëm ekonomik të paarkëtushëm në shumën 102,600 lekë**, për shkak të parashkrimit, pasi në momentin e konstatimit kanë kaluar 3 vjet.

4. Për pagesat e përkthyesve të jashtëm, në kundërshtim me Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Financave nr. 3165, datë 12/5/2004 “Për kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së përkthyesve të jashtëm, tarifat e shërbimit të përkthimit të jashtëm dhe tarifat e përkthimit zyrtar që duhet të paguajnë të tretët”, i ndryshuar, pika 11, duke shkaktuar **dëm ekonomik në shumën 23,070 lekë**.

5. Për likuidimin e shpenzimeve telefonike me celular pa kontratë me operatorin telefonik, dhe mbi kufirin e lejuar në kundërshtim me kërkesat e vendimit të KM nr. 864, datë 23/7/2010 “Për pajisjen me numër telefoni celular të personave juridik publik”, pikat 9 dhe 14, duke shkaktuar **dëm ekonomik në shumën 14,594 lekë**.

“Këshillim”, për:

Z. [REDAKTUAR] me detyrë Përgjegjëse e Sektorit të Shërbimeve Mbështetëse.

Për parregullsitë e konstatuara në hartimin e kërkesave për mallra, punë e shërbime për plotësimin e nevojave që ka institucioni para se të fillojnë procedurat e prokurimit në rastet kur nuk kërkohet botimi i vlerës së kontratës, në kundërshtim me kërkesat e nenit 28, të ligjit nr. 9643, datë 20/11/2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe me nenin 14, të rregullores së brendshme të institucionit.

Bazuar në pikën 1, Kreu II-të i VKM nr. 216, datë 18/4/2007 “Për procedurat e konkurrimit publik, për përzgjedhjen e subjekteve të licencuara, për restaurimin e monumenteve të kulturës”, i ndryshuar, për shkeljet e konstatuara në zbatimin e procedurave të konkurrimit në objektin “Restaurimi i pjesshëm i ish-godinës së Parlamentit të Parë Shqiptar”, mban përgjegjësi juristja e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave [REDAKTUAR] dhe juristja e Njesisë së Hartimit të Dokumenteve të Tenderit [REDAKTUAR] por meqenëse janë punonjëse të jashtme që punojnë në sektorin privat të kontraktuara me kontratë të përkohshme vetëm për zhvillimin e këtij tenderi, nuk mund të rekomandojmë masa disiplinore.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Aleksandër Tereziu Përgjegjës Grupi, Pjetër Beleshi dhe Milo Pano. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit zj. Luljeta Nano, Drejtori i Departamentit z. Ded Trieshi dhe Juristi i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë z. Koço Sokoli (në mungesë të Drejtorit të Drejtorisë dhe me porosi), si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtore e Përgjithshme zj. Helga Vukaj

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT